



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

**SHPLLJE KONKURIMI I HAPUR  
PËR  
VENDET VAKANTE PRANË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit 111/2018 "Për Kadastrën", neni 11, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, shpall konkurimin për pozicionet vakante në DVASHK Gjirokastrë, Krujë dhe Lezhë, si më poshtë:

**Përgjegjës Sektori (2)** në profilin: *ekonomi - financë*. Kategoria: III-b. Niveli minimal i diplomës "Master Shkencor", në Krujë (1), Lezhë (1).

**Përgjegjës Sektori (1)** në profilet: *Gjeodezi; Topografi, Ing. Ndërtimi; Ing. Mjedis; Arkitekturë; Urbanistik*. Kategoria: III-b. Niveli minimal i diplomës "Master Shkencor", në Lezhë (1).

**Specialist** (Arkiv / Protokolli) (2), profili: *Arsim i lartë*, Kategoria: IV-b. Niveli minimal i diplomës "Bachelor" në Gjirokastrë (1), Lezhë (1).

❖ **Kushtet që duhet të plotësojë kandidatët:**

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në legjisllacionin e shërbimit civil sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme, si vijon:**

- Për pozicionet "Specialist" duhet të zotërojnë diplomë të Arsimit të Lartë, nivelit minimal "Bachelor", në profilin e kërkuar dhe, të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në profesion.0020
- Për pozicionet "Përgjegjës Sektori", duhet të zotërojnë diplomë të nivelit minimal "Master Shkencor", në profilin e kërkuar, (Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë) dhe, të kenë të paktën 2 (dy) vite punë në profesion.
- Të mos kenë masë largim nga puna në fuqi.
- Preferohet të kenë trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse.
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së.

❖ **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit.**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat, si më poshtë:

- a) Letër interesi për pozicionin për të cilin është i interesuar kandidati.
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (*përfshirë edhe diplomën Bachelor kur kërkohet Diploma Master Shkencor*). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit;
- d) Fotokopje të librezës së punës (*të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë*);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces në proces hetimi)
- h) Vërtetim nga gjykata (që nuk është në proces gjyqësor).

- i) Vërtetim të gjendjes gjyqësore/ Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
  - j) Referenca (vlerësime) të punëdhënësve të mëparshëm
  - k) Vërtetim nga institucioni/punëdhënësi që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
  - l) Adresën e saktë të vendbanimit, email dhe kontakt telefonik.
  - m) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet, nëpërmjet postës zyrtare, apo dorazi në Zyrën e Protokollit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-t ose në adresën elektronike të ASHK-t [punesime@ashk.gov.al](mailto:punesime@ashk.gov.al)
- Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar është kusht skualifikues.

**Dorëzimi i dokumenteve duhet të bëhet brenda datës: 25.09.2020.**

**❖ Shpallja e rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kandidaturave.**

Në datën **02/10/2020**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore do të njoftojë kandidatët individualisht, (nëpërmjet adresës së e-mail), si dhe nëpërmjet publikimit në ambientet e Drejtorisë Vendore përkatëse, të informacioneve në lidhje me listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret, fazat e testimit, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

**❖ Fushat e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim :**

**I.** Kandidatët për pozicionet Përgjegjës Sektori dhe Specialist, në profilet *Inxhinieri Ndërtimi; Arkitekturë; Urbanistikë; Gjeodezi; Ing. Elektronik, Gjeoinformatikë, Ing Informatik, Shkenca kompjuterike dhe Juridik* do të testohen me shkrim rreth njohurive mbi legjislacionin e mëposhtëm:

Kushtetutën e RSH; Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Ligji 20/20 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”; Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i RSH”, i ndryshuar. (Dispozitat mbi pronësinë); Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i RSH”, i ndryshuar; Ligji nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës më administratën publike”, i ndryshuar; Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me fushën përkatëse.

**II.** Kandidatët për pozicionet në profilin ekonomi financë do të testohen me shkrim rreth njohurive mbi legjislacionin e mëposhtëm:

Kushtetutën e RSH; Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, Ligji 20/20 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës më administratën publike”, i ndryshuar; Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me fushën përkatëse.

**IV.** Kandidatët për pozicionin **Specialist Sektori Arkiv / Protokolli** do të testohen me shkrim rreth njohurive mbi legjislacionin e mëposhtëm:

Kushtetutën e RSH; Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, Ligjin për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare; Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003, “Për

arkivat” dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë këto veprimtari, Ligji nr.9887 datë 10.03.2008 “për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar; Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative; Ligji nr. 8457 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", i ndryshuar; Ligjin nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës më administratën publike”, i ndryshuar Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me fushën përkatëse sipas profilit të kërkuar.

### **Vlerësimi i kandidatëve**

Kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do ti nënshtrohen procedurave të mëtejshme të vlerësimit, nga një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim, në lidhje me:

a - Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;

b - Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 30 pikë

*Gjatë intervistës do të vlerësohen në lidhje me: Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionet për të cilat aplikojnë; Eksperiencën e tyre të mëparshme si dhe motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën).*

c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 30 pikë.

Kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistën e strukturuar me gojë kandidatët të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim gjysmën e pikëve (20 pikë)

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK, Rr. “Dora D’Istria”, Nr.2, Tiranë. Kandidatët që kualifikohen të marrin pjesë në intervistën me gojë do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve (nëpërmjet adresës së e-mail) mbi datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

### **❖ Shpallja e rezultateve të konkurimit**

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail të paraqitur në dokumentacionin e aplikimit).

Kandidati që merr më pak se 50 pikë në total nuk konsiderohet i suksesshëm.